

# ARGUMENTUM

news opinion analysis



**Ambasadori i Azerbajxhanit  
z. Anar Huseynov: Vizita e  
Presidentit Aliyev në Shqipëri  
hapi një faqe të re në  
marrëdhëniet tona dypaleshe**

- Historike/ Tirana dhe Prishtina mbledhje të përbashkët të dy Kuvendeve për 110-vjetorin e Pavarësisë!
- 3 Nëntori berlinez çmontoi Ballkanin e Hapur
- 10 Megakërcënime gjeopolitike!

## Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji. Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

**“Argumentum”, një proces intelektual ...**

**Marjana DODA**  
Kryeredaktore

## Përmbajtja

### 03 INTERVISTA

- Ambasadori i Azerbajxhanit z. Anar Huseynov: Vizita e Presidentit Aliyev në Shqipëri hapi një faqe të re në marrëdhëniet tona dypaleshe

### 08 EDITORIAL

- 10 Megakërcënime gjeopolitike!

### 10 JO VETËM LAJMI

- Historike/ Tirana dhe Prishtina mbledhje të përbashkët të dy Kuvendeve për 110-vjetorin e Pavarësisë!

### 14 OP/ED

- 3 Nëntori berlinez çmontoi Ballkanin e Hapur

### 17 FOKUS

Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet midis Kinës e Ballkanit Perëndimor sfidat dhe mundësitë shpalosen në një forum rajonal të AIGS në Tiranë

### ENGLISH EDITION

### 22 INTERVIEW

- Azerbaijan's Ambassador Anar Huseynov: President Aliyev's visit to Albania opened a new page in our relations through the specific accords reached

### 27 REALPOLITIK

- Berlin dismantled "Open Balkans"! Trump "went for wool and returned shorn"! Njet towarish Putin! World saviours!

### 26 IN FOKUS

- Berlin Process revived with WB countries signing 3 agreements; next Summit to be held in Tirana

### 30 TOP NEWS

- Albania and Kosovo mark 110th anniversary of the proclamation of Independence in style in Tirana

### 31 BALKAN OVERVIEW

- PM Rama assesses as the best ever the relations between Albania and North Macedonia

## EKSKLUZIVE

Intervistë Ekskluzive  
për Argumentum.al me  
Ambasadorin e Republikës  
së Azerbajxhanit në Shqipëri  
SH.T.Z. Anar HUSEYNOV

## Ambasadori i Azerbajxhanit z. Anar Huseynov: Vizita e Presidentit Aliyev në Shqipëri hapi një faqe të re në marrëdhëniet tona dypalëshe



*“Baku dëshiron të diskutojë mundësinë e investimit në infrastrukturën e gazit të Shqipërisë dhe fillimisht të fillojë me një zonë të veçante. Nëse investimi është i suksesshëm, shtrirja e tij mund të rritet.”*

Ambasadori i Republikës së Azerbajxhanit në Shqipëri  
SH.T.Z. Anar HUSEYNOV

INTERVISTOI: MARJANA DODA

**V**izita e Presidentit Ilham Aliyev në Shqipëri është vërtet e para në historinë e marrëdhënieve dypalëshe mes dy vendeve, por u bë jashtëzakonshme pasi nuk ishte thjesht protokollare, reciproke, por hapi një faqe të re në marrëdhëniet dypalëshe nëpërmjet marrëveshjet specifike të arritura. Madje vendimi i marrë nga (Milli Meclis) Parlamenti i Azerbajxhanit për të hapur një ambasadë në Shqipëri tre ditë pas vizitës së Presidentit Aliyev,

është një tjetër dëshmi e synimeve serioze të Bakut për zhvillimin e një bashkëpunimi afatgjatë dhe me përfitim reciprok me Shqipërinë”, kështu thotë Ambasadori i Republikës së Azerbajxhanit në Shqipëri SH.T.Z. Anar HUSEYNOV në një intervistë ekskluzive për Argumentum.al

Delegacioni i nivelit të lartë të Azerbajxhanit zhvilloi një vizitë në Tiranë më 15 nëntor të këtij viti.

Ambasadori tha se çështja e investimeve të ndërsjella është me interes të madh për të dyja

palët. “Ne jemi pro investimeve në Shqipëri dhe kryesisht në fushën e infrastrukturës energjetike. Duke marrë parasysh rritjen e shpejtë të numrit të turistëve që vijnë në vendin tuaj në vitet e fundit, mendoj se investimet në infrastrukturën turistike mund të diskutohen edhe në kuadër të formatit përkatës të ndërveprimeve të ardhshme”, tha Huseynov.

Sipas tij, Baku dëshiron të diskutojë mundësinë e investimit në infrastrukturën e gazit të Shqipërisë dhe fillimisht të fillojë



Pamje nga vizita e Presidentit të Azerbajxhanit në Shqipëri më 15 Nëntor 2022

me një zonë të veçantë dhe nëse investimi është i suksesshëm, shtrirja e tij mund të rritet.

Më tej ai tha se Azerbajxhani ka qenë gjithmonë dhe do të mbetet një nga partnerët kyç dhe të besueshëm të BE-së që kontribuon në sigurinë energjetike të Evropës.

Në një koment për marrëdhëniet mes Azerbajxhanit dhe Armenisë, ambasadori tha se gjatë këtyre dy viteve, Armenia, pavarësisht marrëveshjeve të arritura, vazhdon të përpiqet në çdo mënyrë të mundshme t'i rezistojë zbatimit të plotë të angazhimeve të saj. "Ka vetëm një arsye për këtë qasje – mbajtja e pretendimeve territoriale ndaj Azerbajxhanit. Me fjalë të tjera, Jerevani përpiqet, më vete ose me urdhër të patronëve të tij, të ruajë status quo-në në rajon me shpresën për të fituar kohën. Ajo bën të njëjtin gabim si më parë për gati 30 vjet."

Sipas tij, Azerbajxhani në mandatin e tij ka ndjekur politikën e normalizimit të marrëdhënieve me Armeninë në bazë të parimeve të së drejtës ndërkombëtare duke përfshirë respektimin e integritetit territorial dhe paprekshmërinë e kufijve të njohur ndërkombëtarisht të të dyja vendeve.

I pyetur për qëndrimin e Shqipërisë ndaj integritetit territorial të Azerbajxhanit, ambasadori Huseynov tha se Tirana ka qenë gjithmonë mbështetëse për integritetin tonë territorial dhe jo vetëm në takimet me dyer të mbyllura, siç bëjnë shumë, por edhe në publik dhe brenda organizatave ndërkombëtare. "Ne e vlerësojmë shumë këtë pozicion të Shqipërisë, i cili kontribuon ndjeshëm në zhvillimin e marrëdhënieve tona dypalëshe", tha ambasadori i Republikës së Azerbajxhanit në Shqipëri SH.T. Z. Anar HUSEYNOV në intervistën e mëposhtme:

**Marjana Doda: I nderuar Ambasador, se pari ju falënderoj për mundësinë për të zhvilluar këtë intervistë ekskluzive pas vizitës zyrtare të delegacionit të nivelit të lartë nga Azerbajxhani në Tiranë më 15 Nëntor.**

**-Vizita e Presidentit Ilham Aliyev është cilësuar si një vizitë historike, duke qenë hera e parë që Tiranën e viziton një President nga Azerbajxhani. Një vizitë që shënon një pikë të rëndësishme të marrëdhënies dypalëshe Shqipëri-Azerbajxhan. Mund të na përmendi konkretisht disa nga pikat më të rëndësishme të kësaj vizite në Shqipëri?**

**SH.T.Z Anar Huseynov:** Fillimisht, dëshiroj t'ju falënderoj për këtë mundësi që të ndaj mendimet e mia mbi rezultatin e vizitës shtetërore të Presidentit Aliyev në Shqipëri si dhe zhvillimet e fundit në rajonin tonë. Kjo vizitë është vërtet e para në historinë e marrëdhënieve tona dypalëshe,

por u bë e jashtëzakonshme pasi nuk ishte thjesht protokollare, reciproke, por hapi një faqe të re në marrëdhëniet tona përmes marrëveshjeve specifike të arritura. Midis tyre, fillimisht do të shënoja vendimin e marrë nga Milli Meclis (Parlamenti) i Azerbajxhanit për të hapur një ambasadë në Shqipëri tashmë në ditën e tretë pas vizitës. Ky vendim është një tjetër dëshmi e synimeve serioze të Bakut për zhvillimin e një bashkëpunimi afatgjatë dhe me përfitim reciprok me Shqipërinë.

Në përgjithësi, marrëveshjet e arritura mund të ndahen në ato afatshkurtra dhe afatmesme për sa i përket periudhës së zbatimit të tyre. Pra, tashmë vitin e ardhshëm, në vitin e 30-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes vendeve tona, planifikojmë të zhvillojmë një sërë takimesh për të diskutuar mundësitë e avancimit të bashkëpunimit në sferën politike, ekonomike dhe humanitare. Një theks i madh i kushtohet edhe ndërveprimit kulturor, në veçanti, në vitin 2023 pritet të mbahet në Tiranë Java e kulturës Azerbajxhaniane. Të dyja palët synojnë gjithashtu të forcojnë kuadrin tonë ligjor të bashkëpunimit. Për sa i përket perspektivës afatmesme, do të vazhdojmë me bisedime të drejtpërdrejta për mundësitë e ndërsjella të investimeve në fushat me interes të përbashkët.

**-Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Azerbajxhanit si politikisht dhe ekonomikisht duket se po marrin një hov të ri. Përveç fushës së energjisë dhe gazit, a do të kemi investime dhe bashkëpunime mes**

**kompanive të Azerbajxhanit dhe të Shqipërisë edhe në fusha të tjera të ekonomisë si në sektorin e turizmit dhe jo vetëm?**

– Siç e theksova më lart, çështja e investimeve të ndërsjella është me interes të madh për të dyja palët. Jemi pro investimeve në Shqipëri dhe kryesisht në fushën e infrastrukturës energjetike. Duke pasur parasysh rritjen e shpejtë të numrit të turistëve që vijnë në vendin tuaj vitet e fundit, mendoj se investimet në infrastrukturën turistike mund të diskutohen edhe në kuadrin e formatit përkatës të ndërveprimeve të ardhshme. Besoj se krahas atraktivitetit komercial të kësaj zone, shkëmbimi i flukseve turistike mund të kontribuojë jashtëzakonisht shumë në kontaktet mes njerëzve mes vendeve tona.

**- Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) është një nga investimet e huaja më të rëndësishme në Shqipëri, mbi të gjitha për rëndësinë strategjike që i jep vendit, megjithatë ne nuk kemi Infrastrukture për gazifikimin e vendit. A mundet Shqipëria që nga një vend tranzit në kuadër të TAP-it, të kthehet edhe në një vend përfitues i gazit natyror Azerbajxhanas?**

– Unë besoj se Shqipëria mund të bëhet një përfituese e gazit natyror të Azerbajxhanit, por siç e keni vënë re vetë, mungesa e infrastrukturës së përshtatshme e ndërlikon çështjen.

Prandaj, Baku dëshiron të diskutojë mundësinë e investimit në infrastrukturën e gazit të Shqipërisë dhe fillimisht të fillojë me një zonë të veçante. Nëse investimi është i suksesshëm,

shtrirja e tij mund të rritet.

**-Z. Ambasador, në vazhden e luftës Rusi-Ukrainë dhe përballë kërcënimit të krizes energjitike, ka ripërtërirë interesin për Kaukazin si burime potenciale të energjisë duke u bërë kështu një alternativë e rëndësishme ndaj Rosisë për naftë dhe gaz. Por a rrezikohen marrëdhëniet ndërmjet Rosisë dhe Azerbajxhanit në sajë të këtij zhvillimi?**

– Nëse e keni fjalën për Azerbajxhanin duke iu referuar Kaukazit, atëherë do të thoja që vëllimet tona të eksporteve të naftës dhe gazit nuk janë të krahueshme me ato të Rosisë dhe ne nuk kemi qenë kurrë konkurrentë në tregjet evropiane. Edhe pse në dekadat e fundit shumica e iniciativave tona rajonale dhe ndërrajonale në fushën e energjisë janë përballur me rezistencë të caktuar, por së bashku me partnerët ndërkombëtarë kemi arritur t'i zbatojmë.

**-Një Memorandum Mirëkuptimi për Partneritetin Strategjik në fushën e energjisë midis Republikës së Azerbajxhanit dhe Bashkimit Evropian është nënshkruar midis Azerbajxhanit dhe BE-së në Korrik të këtij viti. Cfarë përmban konkretisht ky memorandum?**

Më 18 korrik 2022, Presidenti Aliyev dhe Znj. Ursula von der Leyen, Presidente e Komisionit të BE-së, nënshkruan një Memorandum të ri Mirëkuptimi për një Partneritet Strategjik në fushën e Energjisë. Ky Memorandum u bë një moment historik i ri në marrëdhëniet tona me BE-në dhe përfshin një angazhim për të dyfishuar kapacitetin e

Korridorit Jugor të Gazit për të ofruar të paktën 20 miliardë metra kub në tregjet evropiane çdo vit deri në vitin 2027. Kjo do të kontribuojë në objektivat e diversifikimit të BE-së. Azerbajxhani tashmë po rrit dërgesat e gazit natyror në BE, nga 8.1 bcm në 2021 në 12 bcm që pritet në 2022. BE dhe Azerbajxhani ndajnë gjithashtu ambicien për të përshpejtuar zhvillimin dhe vendosjen e kapaciteteve të prodhimit dhe transmetimit të energjisë së rinovueshme për të korrur plotësisht sinergjitë midis tranzicionit të energjisë së pastër të BE-së dhe potencialit të fuqishëm të pashfrytëzuar të energjisë së rinovueshme të Azerbajxhanit, veçanërisht në sektorin e energjisë në det të hapur.

Të dy palët pranojnë gjithashtu rëndësinë e zotimit Global për Metanin dhe pranojnë se bërja e zinxhirit të furnizimit me gaz natyror sa më efikas, miqësor ndaj mjedisit dhe klimës është një përgjegjësi kolektive.

Memorandumi i Mirëkuptimit mbështet krijimin e skemave për grumbullimin e gazit natyror që përndryshe do të ajroset, do të ndizej ose do të lëshohej në atmosferë. Pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit, palët ranë dakord që të zhvillojnë dialogun energjetik BE-Azerbajxhan në nivel ministror për të diskutuar zbatimin praktik të këtij Memorandumi. Azerbajxhani ka qenë gjithmonë dhe do të mbetet një nga partnerët kyç dhe të besueshëm të BE-së që kontribuon në sigurinë energjetike të Evropës.

**-Gazi natyror i Azerbajxhanit po i kontribuon sigurisë energ-**

**jitike të Europës. A është kjo një mundësi që Brukseli dhe Uashingtoni t'i japin përparësi dhe të lartësojnë marrëdhëniet me Bakun?**

-Mendoj se është më mirë t'ia parashtroni këtë pyetje Brukselit dhe Uashingtonit. Baku është e gatshme të forcojë marrëdhëniet e saj me partnerët e saj perëndimorë bazuar në partneritet të barabartë, interes të ndërsjellë dhe respekt për parimet e së drejtës ndërkombëtare.

**-Zoti Ambasador kanë kaluar dy vite nga nënshkrimi i deklaratës trepalëshe nga liderët e Armenisë, Azerbajxhanit dhe Rusisë më 9-10 nëntor 2020, por pavarësisht kësaj marrëveshjeje, armpushimi ndërmjet dy vendeve ka qenë i brishtë dhe është shkelur disa herë, sikundër ndodhi dhe në shtator të këtij viti. Kush nuk po i përmbahet marrëveshjes dhe pse?**

- Pas deklaratës trepalëshe të 10 nëntorit, të gjitha përpjekjet

e bëra në formate të ndryshme kishin për qëllim kryesisht përmbushjen e paragrafëve të deklaratës së nëntorit 2020, të cilat i shërbejnë qëllimit të normalizimit të marrëdhënieve midis Azerbajxhanit dhe Armenisë. Për fat të keq, Jerevani, në kundërshtim me paragrafin 4 të deklaratës së lartpërmendur, ende mban dhe financon trupat armene në territorin tonë të njohur ndërkombëtarisht, ku janë vendosur përkohësisht "forcat paqeruajtëse të Federatës Ruse". Zbatimi i paragrafit 9, i cili thotë "Republika e Armenisë garanton sigurinë e lidhjeve të transportit midis rajoneve perëndimore të Republikës së Azerbajxhanit dhe Republikës Autonome të Nakhchivanit të Azerbajxhanit, me qëllim që të organizohet lëvizja e papenguar e personave, automjeteve dhe ngarkesave në të dy drejtimet. "po ashtu është vonuar artificialisht, do të thosha për arsye të ndryshme absurde. Paragrafi 7 i referohet personave të zhvendosur brenda vendit dhe refugjatëve që do të zhvendosen në vendet e tyre të origjinës, zbatimi i këtij paragrafi gjithashtu nuk është i mundur jo vetëm për shkak të shkatërrimit të plotë të territoreve të çliruara, por edhe për shkak të kontaminimit të rëndë të saj nga minat nga Armenia.

Gjatë këtyre dy viteve, Armenia, pavarësisht marrëveshjeve të arritura, vazhdon të përpiqet në çdo mënyrë të mundshme t'i rezistojë zbatimit të plotë të angazhimeve të saj. Ekziston vetëm një arsye e kësaj qasjeje – mbajtja e pretendimeve territoriale ndaj Azerbajxhanit. Me fjalë të tjera, Jerevani përpiqet, më vete ose

**Mendoj se është më mirë t'ia parashtroni këtë pyetje Brukselit dhe Uashingtonit. Baku është e gatshme të forcojë marrëdhëniet e saj me partnerët e saj perëndimorë bazuar në partneritet të barabartë, interes të ndërsjellë dhe respekt për parimet e së drejtës ndërkombëtare.**

me urdhër të patronëve të tij, të ruajë status quo-në në rajon me shpresën për të fituar kohën. Ajo bën të njëjtin gabim si më parë për gati 30 vjet.

Azerbajxhani në mandatin e tij ka ndjekur politikën e normalizimit të marrëdhënieve me Armeninë bazuar në parimet e së drejtës ndërkombëtare duke përfshirë respektimin e integritetit territorial dhe paprekshmërinë e kufijve të njohur ndërkombëtarisht të të dy vendeve. Pavarësisht agjendës paqësore të Azerbajxhanit të ndërtuar mbi zbatimin e deklaratës përkatëse trepalëshe, të drejtës ndërkombëtare dhe rivendosjes së marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Armenia dhe diaspora armene jo vetëm që mashtron qarqet politike dhe shoqëritë e vendeve të ndryshme në realitet në vend, por gjithashtu përpiqet të prishë marrëdhëniet tona dypalëshe me ato vende duke nxitur urrejtje dhe armiqësi ndaj Azerbajxhanit.

**-Si e shikoni qasjen ndërkombëtare përballë këtij konflikti? A mendoni se është koha që SHBA dhe BE të angazhohen më shumë në konfliktin Armeni-Azerbajxhan duke shkuar kështu drejt një ndërmjetësimi ndërkombëtar për zgjidhjen e tij?**

- Ndërsa më 10 nëntor 2020 ndërmjetësimi për zbatimin e deklaratës përkatëse trepalëshe dhe normalizimin e marrëdhënieve Azerbajxhano-Armene është përmbushur kryesisht nga Rusia, por që nga fundi i vitit 2021 BE (në nivelin e Presidentit të Këshillit Evropian) dhe nga mesi i këtij viti, në procesin e ndërmjetësimi janë përfshirë edhe SHBA (në nivelin e Sek-

Tirana ka qenë gjithmonë mbështetëse për integritetin tonë territorial dhe jo vetëm në takimet me dyer të mbyllura, siç bëjnë shumë, por edhe në publik dhe brenda organizatave ndërkombëtare. Ne e vlerësojmë shumë këtë pozicion të Shqipërisë, i cili kontribuon ndjeshëm në zhvillimin e marrëdhënieve tona dypalëshe.

retarit të Shtetit).

Sot mund të flasim për qëndrimin e përbashkët të Perëndimit, i cili është mjaft racional insistimi për nënshkrimin e marrëveshjes së paqes deri në fund të këtij viti. Fillimisht, Armenia ishte mbështetëse për këtë pozicion, por pas takimit të Samitit të Soçit të 2 nëntorit, siç ndodh gjithmonë, Jerevani përsëri filloi të devijojë nga marrëveshjet e mëparshme duke anuar drejt propozimeve të reja të Kremlinit.

Takimi i ardhshëm trepalësh i Samitit të BE-së, Azerbajxhanit dhe Armenisë është planifikuar të mbahet më 7 dhjetor në Bruksel, por presidenti armen insistoi që presidenti i Francës t'i bashkohet takimit të nivelit të lartë. Autoritetet tona ranë dakord për këtë format të takimit të mbajtur së fundmi në Pragë, por pas zhvillimeve të fundit të njohura, Baku nuk e konsideron më Francën si një ndërmjetëse të drejtë. Pra, presidenti Aliyev duhej të refuzonte takimin e radhës në Bruksel nëse nuk mbetet formati trepalësh. Ne e njohim fqinjin tonë dhe kemi qenë dëshmitarë të këtyre lëvizjeve, hipokrizisë dhe manipulimeve për shumë dekada. Megjithatë, ne shpresojmë se

paqja dhe bashkëpunimi i plotë në rajonin tonë do të mbizotërojë së shpejti.

**-Si e vlerësoni qëndrimin e Tiranës zyrtare ndaj integritetit territorial të Azerbajxhanit?**

-Tirana ka qenë gjithmonë mbështetëse për integritetin tonë territorial dhe jo vetëm në takimet me dyer të mbyllura, siç bëjnë shumë, por edhe në publik dhe brenda organizatave ndërkombëtare. Ne e vlerësojmë shumë këtë pozicion të Shqipërisë, i cili kontribuon ndjeshëm në zhvillimin e marrëdhënieve tona dypalëshe.

**-Z. Ambasador, duke qenë se Azerbajxhani është gjithnjë e më i rëndësishëm për stabilitetin afatgjatë të rajonit. Cila është mënyra më e mirë për t'i dhënë fund kësaj lufte destabilizuese dhe për të sjellë një Paqe përfundimtare në Kaukazin e Jugut?**

-Mënyra më e mirë për të sjellë paqen në Kaukazin e Jugut është që të përmbahen nga pretendimet territoriale, të rivendosen marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe të promovojnë bashkëpunimin dypalësh dhe rajonal bazuar në të drejtën ndërkombëtare.

# 10 MEGAKËRCËNIMET

## Gjeopolitike

EDITORIAL I ARGUMENTUM

Po, aq janë, dhe këtë e thotë tani së fundi një “Star” ekonomist botëror, Nouriel Roubini në librin e tij “best seller” të promovuar më 20 Tetor” 10 Megakërcënime – 10 prirje që rrezikojnë të ardhmen tonë dhe si t’u mbijetojmë” (Ten Megathreats-Ten Trends that imperil our future and how to survive them” Roubini deri në vitin 2008 njihej me nofkën “Dr. Doom (Katastrofa) për shkak të profecive të tij negative. Ai parashikoi me saktësi qysh në fillimin e viteve 2000 krizën e rëndë financiare të vitit 2008; mirëpo, askush nuk e besoi deri kur ajo ndodhi. Nga ajo kohë, fjala dhe mendimi i tij dëgjohet me vëmendje, duke e konsideruar tashmë si “Dr. Realisti”. Libri i tij i lartpërmendur ka shkaktuar interes, vëmendje pse jo dhe panik në mjediset politike, mediatike, ekonomike dhe publike.

Sipas këtij “star” ekonomisti, planeti tanimë kërcënohet jo më nga një e dy, por nga 10 rreziqe të përmasave të mëdha. Ato janë: lufta e Rusisë në Ukrainë, konflikti Iran – Izrael, Kinë – SHBA, demokracia, klima, ngrohja globale, borxhet, stagflacioni,

pandemitë dhe paaftësia e shoqërive të sigurimit shëndetësor në kushtet e plakjes masive të popullsisë.

Një kontrast i fortë me vitet 60-70, kur situata ishte shumë më e mirë në të gjitha drejtimet. Roubini që ka lindur në Stamboll, por i ka jetuar vitet 60-70 në Itali kujton se në ato vite ndiheshin mirë, nuk kishte kërcënime bërthamore, ishte detanta midis BS dhe Perëndimit, nuk njiheshin pandemitë si COVID – 19, as ngrohja globale, papunësia, borxhet ishin nën kontroll dhe të menaxhueshme, popullsia ishte e re në moshë, shoqëritë e sigurimeve nuk kishin borxhe dhe nuk ishin të tejmbytura me detyrime financiare si sot; edhe inflacioni ishte lehtësisht i administrueshëm. Demokracia ishte stabël edhe pse jo perfekte. Tronditjet gjeopolitike ishin fare të vogla dhe të ralla krahasuar me të sotmit.

Ndaj, historiani i famshëm Niall Ferguson thotë se “do të jemi me fat nëse do të kishim një krizë si ajo e viteve 70 por jo luftë si në vitet 40”!


Mirëpo, sot po ndodh krejt

e kundërta. 10 megakrizat e rrezikshme janë planetare, të njëkohshme dhe të lidhura pazgjidhshmërisht me njera tjetrën; me mundësi shumë të vogla ndërhyrjeje dhe manovrimi, sepse ato shkaktojnë pasoja të tjera jo më të vogla. Në këto kushte, ndonëse i domosdoshëm, edhe prioritizimi gjatë trajtimit dhe përballimit të tyre nuk jep garanci, sepse secila nga 10 krizat ka 10 nënkriza të tjera. Kështu, sot prioriteti absolut është përballimi i pasojave të rënda të agresionit rus ndaj Ukrainës, pastaj vjen konflikti Iran – Izrael dhe Kinë – SHBA. Mirëpo kjo nuk do të thotë që të lihen pasdore, përkundrazi, të trajtohen me po atë theks inflacioni, borxhet, pandemitë, ngrohja globale, papunësia, azili, etj.

Se sa serioze janë këto megareziqe për çdo vend, sado i madh dhe i fuqishëm të jetë, Roubini jep rastin e SHBA-ve. Kështu, në Kaliforni fermerët do të shesin të drejtat e ujit, sepse nuk kanë më leverdi ta përdorin atë në bujqësi. Në Florida agjencitë nuk do të bëjnë më sigurimin e banesave të shkatërruara nga fatkeqësitë natyrore. Për pasojë, pritet që



**Se sa serioze janë këto megarreziqe për çdo vend, sado i madh dhe i fuqishëm të jetë, Roubin jep rastin e SHBA-ve. Kështu, në Kaliforni fermerët do të shesin të drejtat e ujit, sepse nuk kanë më leverdi ta përdorin atë në bujqësi. Në Florida agjencitë nuk do të bëjnë më sigurimin e banesave të shkatërruara nga fatkeqësitë natyrore. Për pasojë, pritet që gjysma e amerikanëve në të ardhmen të zhvendosen në pjesën qendrore ose në Kanada.**



gjysma e amerikanëve në të ardhmen të zhvendosen në pjesën qendrore ose në Kanada.

Ose le të marrim krizën kërcënuese mbas një pushtimi hipotetik të Tajvanit nga Kina, që sipas disa të dhënave mund të ndodhë deri në vitin 2030, edhe pse nuk është e thënë detyrimisht. Mirëpo kjo do të verë në rrezik 50 për qind të vëllimit botëror të gjysëm përçuesave dhe 80 për qind të sofistikuar. Kjo mbasi sot ne jemi më të varur prej përçuesave se sa prej naftës!

Lidhur me përhapjen e teknologjisë së përparuar kineze 5 G, autori tregon se në përgjigje të pyetjes së tij përse përdornin atë teknologji që bart rrezikun e spiunimit, Presidenti i një vendi afrikan i kishte thënë se si vend i vogël kushdo mund t'i spiunojë ata, mirëpo parapëlqejnë Kinën,

se i ka tarifat më të lira!

Borxhi është bërë shqetësim i madh kërcënues kudo. Aktualisht borxhi planetar është sa 350 për qind e GDP-së; borxhi privat dhe publik në 50 vitet e fundit janë rritur nga 100 në 420 për qind. Problemi i madh është se çdo ndërhyrje rrezikon përkeqësimin e treguesve të tjerë ekonomikë dhe financiarë, sidomos rritjen ekonomike dhe punësimin.

Ose rritja e normave të interesit, si një mënyrë për të mbajtur nën kontroll inflacionin vërtet mund të shtyjë skadencën e borxheve, por do t'i bëjë ato më të shtrenjta, duke krijuar telashe të tjera. Plakja e popullsisë, rënia e ritmeve të lindjes, emigracionet masive kanë krijuar probleme dhe në pakësimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe paaftësinë e kompanive të sigurimit dhe të shtetit për të përballuar fluksin në rritje të numrit të pensionistëve. Kjo tashmë ka prekur dhe vendet e zhvilluara, ndërsa në vendet e tjera situata

është dhe më keq. Kështu, në 20 vendet më të zhvilluara, llogaritet se kompanitë e sigurimit kanë 780 miliard Euro boxhe.

Po kështu, në fushën e mbrojtjes së klimës dhe ngrohjes globale, reduktimi i emetimit të gazrave karbonikë CO2 mund të dobësojë dhe të ulë ritmet ekonomike me probleme dhe pasoja të tjera të dëmshme.

« Ngushëllimi » për menazhimin e këtyre 10 krizave që të mos arrijnë « pikën e vlimit » është një administratë dhe qeverisje më e përkushtuar, më e aftë dhe në bashkëpunim të ngushtë ndërkombëtar.

Së fundi, këto parashikime të besueshme Roubinit janë kambana të fuqishme alarmi për aktorët dhe faktorët politikë, ekonomikë, financiarë dhe socialë në vendin tonë dhe në radhë të parë të qeverisë. Ca më tepër se në vend të « qeverisjes së mirë » po shihet gjithnjë e më tepër mosqeverisje dhe mungesë përgjegjësie.

# Tirana dhe Prishtina mbledhje të përbashkët të dy Kuvendeve për 110-vjetorin e Pavarësisë!



110 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë bëri bashkë për herë të parë mbledhjen e dy kuvendeve këtej dhe matanë Drinit, të Kosovës dhe Shqipërisë duke e bërë këtë ditë një ditë historike.

Kuvendi i Shqipërisë, mirëpriti kuvendin e Kosovës, në vigjilje të 110 vjetorit të pavarësisë së vendit tone duke u bërë bashkë për herë të parë në prag të kësaj ditë të rëndësishme për mbare shqiptarët njësoj si 110 vite më parë ku u ngrit Flamuri Kuq e Zi në Vlorë me Ismail Qemalin dhe Isa Boletinin.

Përtej simbolikes tejet të rëndësishme që mbart kjo ditë, gjatë kësaj mbledhje të përbashkët ministrat, kreret grupeve parlamentare u zotuan për më shumë bashkëpunim konkret e për më shumë vëllazeri mes njëri-tjetrit për t'i mbrojtur in-

teretat jetike të kombit shqiptarë.

Dy krerët e Kuvendeve, Lindita Nikolla dhe Glauk Konjufca kërkuar që kufinj të shndërrohen në barriera formale.

“Shqipëria dhe Kosova si dy entitete politike të Shqiptarëve në Ballkan dhe me aspiratë integrimin evropian duhet të bashkëndajnë përgjegjësinë për të materializuar vullnetin e shqiptarëve për t'i shndërruar kufijtë shtetërore mes dy vendeve, por edhe me vendet fqinje në kufij

formale”, u shpreh Nikolla.

Ndërsa Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit të Kosovës u ndal tek rreziku që vjen nga Serbia, duke kërkuar ndihmën e Tiranës zyrtare.

“Serbia nuk e fsheh aspak qëllimin e saj, që është destabilizimi i Kosovës dhe ndarja faktike e shtetit tonë, Serbia na lufton nga brenda dhe jashtë, pa zgjedhur mjete, prej diplomacisë deri te financimi dhe kontrollimi i grupeve që janë të lidhura me krim-



in brenda vendit tonë. Sa më afër njëra-tjetrës Shqipëria me Kosovën, aq më lehtë do të jetë për t'i mbrojtur interesat jetike të kombit tonë”, theksoi Konjufca në fjalën e tij para deputetëve shqiptarë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti deklaroi sot se dy vendet duhet të thellojnë bashkëpunimin, të ndajnë ide me njëri-tjetrin, të pranojnë perspektivat e ndryshme, e kritikën ndaj njëri-tjetrit, pasi, theksoi ai, hapësira publike, politika, kultura dhe ekonomia nuk janë çifligje të bllokuara me tapi, por e përbashkëta, kalaja ku vënë të gjithë nga një gurë.

Në fjalën e tij, në seancën e përbashkët të dy Kuvendeve që u mbajt në Tiranë, me rastin e 110 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, Kurti uroi shqiptarët anekënd botës, duke e cilësuar këtë si festë e shenjtë për identitetin kombëtar.

“Deklarata e Pavarësisë eidenton Ismail Qemalin si prijës mes të barabartëve, pra si prijës republikan. Sipas shumë studiuesve mendohet se deklarata



është shkruar nga ministri i parë i arsimit, Luigj Gurakuqi. Por 7 vite më pas, teksa në rendin e ditës ishte Traktati i Londrës dhe copëritmi i mëtejshëm i trojeve shqiptare, vetëm pak ditë para festës së Flamurit, Gurakuqi kërkonte bashkim kundër çdo copëtimi e shkruante: festa e 28 nëntorit duhet të jetë për ne të gjithë, jo vetëm ditë gëzimi, por edhe pendimi në të cilën duhet të bëjmë shqyrtimin e vetdijës sonë. Në këtë ditë duhet të vënë të gjithë dorën në zemër e të pyesin vetës nëse kemi bërë gjithmonë detyrën që kishim për atdheun. T’i tregojmë pa turp e t’i njohim fajet tona, të harrojmë armiqësitë që na ndajnë, t’i japim vëllazërisht dorën njëri-tjetrit dhe të betohemi mbi besën e gjyshërve tanë se sot e më pas do

të përpiqemi me të vërtetë për të mirën e Atdheut, për lulëzimin e kombit, për nderin e flamurit tone”, tha kryeministri Kurti.

Kurti theksoi se ndarjet krahinore ishin edhe dje e edhe sot pengesë.

“Gurakuqi vet nuk mjaftohej me Shkodrën e gegnin. Ai ishte pjesëmarrës edhe në toskëri e Kosovë, ashtu siç nuk mjaftohej Çerçizi me Gjirokastrën, Hasani me Prishtinën, Parashqevi e Sevasti Qiriazzi me Manastirin, Mehmet Pasha me Tetovën, apo Bajram e Isa Begu me Kosovën. Ndarjet krahinore ishin pengesë atëherë e janë edhe sot. Prandaj duhet të gëzohemi kur përfshihemi sa më shumë në jetën publike të njëri-tjetrit, jo për të penguar por për të kontribuar. Hapësira jonë publike, politika, kultura dhe ekonomia nuk janë çifligje të bllokuara me tapi, por e përbashkëta, kalaja ku vëmë të gjithë nga një gurë”, tha ai.

Kurti vuri theksin në rëndësinë e të qenurit më shpesh bashkë.

“Duhet të jemi më shpesh bashkë, jo vetëm në festa, jo vetëm politikanët, na duhet të punojmë bashkë, të ndajmë ide me njëri-tjetrin, të pranojmë perspektivat e ndryshme e kritikën ndaj njëri-tjetrit, pra të punojmë së bashku”, u shpreh Kurti.

## KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI

**“Duhet të jemi më shpesh bashkë, jo vetëm në festa, jo vetëm politikanët, na duhet të punojmë bashkë, të ndajmë ide me njëri-tjetrin, të pranojmë perspektivat e ndryshme e kritikën ndaj njëri-tjetrit, pra të punojmë së bashku”**

Kryeministri i Kosovës, po ashtu theksoi se thellimi i ndarjes nuk i shërben kombit.

“Teksa në Evropën Lindore po vinte demokracia e muri i Berlinit ra, e Gjermania festonte lirinë, duke u bashkuar, një shkencëtar e politolog kosovar Ukshin Hoti thoshte se: politikanët shqiptarë duke thelluar ndarjen mes tyre përtej kufijve të demokracisë, po ju japin arsye atyre që dëshirojnë ti shohin të ndarë si popull. Në veprën e tij madhore “Filozofia politike e çështjes shqiptare”, ai kërkon nga politikanët shqiptarë që të kenë si prioritet kryesor pozitën ndërkombëtare të Kosovës së Shqipërisë dhe jo atë vetjake. Jam i sigurtë që shumica këtu bini darkord brenda vetes me mesazhet e Luigjit dhe Ukshinit”, deklaroi Kurti.

Për Kurtin problem më i mprehtë i dy vendeve, në këto momente, është largimi i të rinjve, ndërsa premtoi se nuk do të reshte përpjekjet për përmirësimin e shtetbërjes dhe kthimin e besimit në institucione.

“Situata nuk është kurrë rozë dhe nëse ndalim përpjekjen e pushojmë se punuari, rrezikojmë. Pra rreziku është mosverpimit, jo verprimi, Vendet tona ballafaqohen me probleme, më i mprehti është largimi i rinisë. Dua t’u dërgoj një mesazh atyre që morën rrugën e dhimbshme të kurbetit. Kjo ditë është edhe e juaja. Mërgimtarët janë mbështetja më e madhe ekonomike për vendet tona e familjet e tyre, por edhe burim demokratizimi e kulture. E di që skemi bërë ende mjaftueshëm që tu kthejmë besimin në institucione, që ju të mendoni rritjen e fëmijëve tuaj në atdheun tuaj,



si opsionin më të mirë. Premtoj se këtë betejë do ta bëjmë deri në fund edhe me ndihmën tuaj”, tha ai.

Kryeministri Edi Rama deklaroi në mbledhjen e përbashkët të Kuvendeve Shqipëri-Kosovë, se “marrëdhëniet mes nesh nuk janë më të shkëlqyera vetëm sepse jemi dy vende të ndara me dy shtete por të bashkuara me një zemër, por janë edhe produktive më shumë se sa kanë qenë kurrë ndonjëherë tjetër”.

“Këtë e tregojnë faktet e provuara nga jo thjesht mbledhjet e përbashkëta të përvitshme mes dy qeverive por nga vullneti dhe rritja e aftësisë. Mjafton të shikosh të dhënat e shkëmbimeve tregtare apo lirinë e lëvizjes së deri djeshme, që dukej mision i pamundur. Apo abetaren e përbashkët, një tjetër ngjarje shumë e rëndësishme dhe shumë e vonuar por e realizuar. Apo punën e përbashkët për fjalorin enciklopedik shqiptar dhe historinë e shqiptarëve, një punë e marrë përsipër nga Akademitë tona të Shkencave”, tha Rama.

Ai theksoi se mjafton të shohësh bashkëpunimin e përditshëm në fushën e energjisë, apo punën e

nisur për të bërë realitet veprën më të madhe të së ardhmes portin dhe hekurudhën.

Kryeministri informoi se në fillim të vitit të ardhshëm ne hapim garën ndërkombëtare për portin e ri të Durrësit, i cili do të ndërtohet në Porto Romano.

“Nëse gjithçka shkon sipas planit, në fillim të 6-mujorit të dytë të vitit të ardhshëm ne do të jemi në kantier. Do të jetë një port i përbashkët i shtrirë nga Durrësi në Prishtinë dhe Strugë me dy Porte të Thata që do të lidhen me hekurudhën. Për hekurudhën Durrës-Prishtinë tani hymë në fazën e fizibilitetit, ndërsa për hekurudhën tjetër jemi në diskutimet me BE-në dhe qeverinë e Maqedonisë së Veriut”, informoi Rama.

Rama informoi se në 12 dhjetor do të bëhet prezantimi i madh publik i projektit përfundimtar të Portit të Durrësit, ku shpreson të jenë të pranishëm kryeministri i Kosovës Kurti dhe ministrat e tjerë.

“Pasi kemi parashtruar publikisht konceptin për portin e ri, në 12 dhjetor prezantojmë publikisht projektin përfundimtar të kompanisë që do t’i nënshtrohet garës dhe do të fillojë nga puna në mesin e vitit 2023”, tha Rama.

# 3 Nëntori berlinez çmontoi Ballkanin e Hapur



Nga Dr. JORGJI KOTE

**M**e ftesë të Kancelarit gjerman Olaf Scholz, më 3 Nëntor 2022 u zhvillua në Berlin Samiti i Ballkanit Perëndimor. Ai bëri rijetësimin e Procesit historik të Berlinit, pas një pauze 18 mujore, për shkak të zgjedhjeve të vjetshme parlamentare dhe krijimit të koalicionit qeveritar gjerman. Ky Samit pasoi Takimin e Ministrave të Brendshëm dhe të Jashtëm më 20/21 Tetor, po në Berlin, ku u miratuan 3 marrëveshje jetike dhe të prekshme për qytetarët tanë, të cilat u nënshtruan më 3 nëntor.

Ndërkohë, Presidentja e Komisionit European, Ursula von der

Leyen, e pranishme në Samit, njoftoi akordimin e 1 miliard Euro për të 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, për kapërcimin e krizës energjitike; gjysma e shumës do të disbursohet qysh në janarin e ardhshëm. Gjithashtu, Kancelari Scholz dhe të tjerë këmbëngulën për një zgjidhje të shpejtë përfundimtare të dialogut Prishtinë – Beograd, sipas modelit franko-gjerman; të shoqëruar me kërkesën ultimative ndaj Serbisë për përcaktimin e qartë të qëndrimeve të saj pro – BE-së dhe Aleancës Perëndimore, kundër Rusisë, politikave të saj agresive dhe lufës në Ukrainë.

Natyrisht që kryetema në Berlin dhe më tej ishte përsheptimi i negociatave të antarësimit në BE,

nëpërmjet realizimit pa vonesa dhe mungesa të reformave të brendshme demokratike dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal. Falë këtij “katalogu” të larmishëm gjithëpërfshirës, Procesi i Berlinit rinisi vrullshëm, me arritje konkrete, të prekshme dhe bindëse.

Nga ana tjetër, ky 3 Nëntor Berlinez e gjeti “sfidantin” e tij të vetëshpallur, “Ballkanin e Hapur” në ditët e veta më të këqia, çyryk dhe gjysmak, të paraprirë me lajme, ngjarje, komente dhe parashikime negative në të gjitha frontet, sidomos pas agresionit rus ndaj Ukrainës dhe qëndrimeve refraktare serbe në kundërshtim me linjën e BE-së dhe SHBA-ve.

Në Shkup opozita është rebeluar dhe ka dalë haptas kundër, duke venë në dyshim qëndrueshmërinë e Maqedonisë së Veriut në këtë nismë. Abazoviç që e përkrahu privatisht “ka rënë nga fiku kryeministrot” dhe bashkë me të dhe prania e Malit të Zi në “Ballkanin e Hapur”. Think Tank i shquar “Rockefeller” dhe disa “asa” të opinionbërjes politike amerikane për rajonin tonë – Prof. Daniel Server, Eduard Joseph dhe Janus Bugajski i kanë bërë “autopsinë” duke e shpallur “non -grata”.

As Samiti i Beogradit me 1 – 4 Shtator, megjithëse vera dhe konjaku ballkanik “u derdh lumë” nuk solli ndonjë gjë të re. Asnjë fjalë për të gjatë Dialogut Strategjik me SHBA-të më 25 Tetor, siç kishte paralajmëruar Kryeministri Rama më parë, as gjatë vizitës së Presidentes së Komisionit European, Ursula von der Leyen në Tiranë më 27 Tetor. Të gjitha këto “tersllëqe” politike ndodhën 3 vjet pas lançimit të bujshëm të “Mini-Schengen në Novi Sad.

Ja pse, në prag, gjatë dhe pas Samitit të Berlinit, me përrjashim të zërit të mekur për Ballkanin e Hapur nga Rama sot në Berlin, në Tiranë, Shkup dhe Beograd “ka rënë heshtje varri”, “as gëk as mëk”; pa prononcime, pa atmosferë, pa “cicërima” të titterash, aq sa dhe 3 Vjetori i “Ballkanin e Hapur” u la në harresë.

Ky “memecllek” pas megalomanisë së mëparshme të dalë boje është i kuptueshëm, sepse 3 Nëntor i Procesit të Berlinit është dhe datë – skadenca e “Ballkanin e Hapur”, edhe pse ai “lindi i mbyllur. Ai do të mbetet në li-



**3 Nëntor i Procesit të Berlinit është dhe datë – skadenca e “Ballkanin e Hapur”, edhe pse ai “lindi i mbyllur. Ai do të mbetet në librat e historisë politike rajonale si relike, referencë dhe model i përcudnuar i amatorizmit diplomatik. Mirëpo, nëse në art, në sport dhe në fusha të tjera ky amatorizëm nuk sjell ndonjë të keqe, në diplomaci dhe gjeopolitikë, me ligje dhe rregulla tejet të ngurta disa shekullore, amatorizmi është shumë i dëmshëm dhe i rrezikshëm, sepse të çon në aventurizëm politik/diplomatik. Doemos që Beogradit i intereson dhe i pëlqen ky dilentantizëm për realizimin më lehtë të synimeve të tij të njohura, në kuadrin e krijimit të “botës së madhe serbe”; mirëpo, ç’kukur kemi në të tjerët dhe sidomos Kosova!**

brat e historisë politike rajonale si relike, referencë dhe model i përcudnuar i amatorizmit diplomatik. Mirëpo, nëse në art, në sport dhe në fusha të tjera ky amatorizëm nuk sjell ndonjë të keqe, në diplomaci dhe gjeopolitikë, me ligje dhe rregulla tejet të ngurta disa shekullore, amatorizmi është shumë i dëmshëm dhe i rrezikshëm, sepse të çon në aventurizëm politik/diplomatik. Doemos që Beogradit i intereson dhe i pëlqen ky dilentantizëm për realizimin më lehtë të synimeve të tij të njohura, në kuadrin e krijimit të “botës së madhe serbe”; mirëpo, ç’kukur kemi në të tjerët dhe sidomos Kosova!

Ky amatorizëm dhe aventurizëm diplomatik u shfaq qysh në krijimin e Mini-Schengenit në Tetor 2019, kur BE-ja i tha përkohësisht “Jo çeljes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Kësisoj, Mini-Schengeni lindi si karshillëk ndaj Berlinit/Brukselit; protagonistët e tij e përforcuan këtë perceptim publik kur deklaruan “Ballkani për

Ballkanasit” dhe me “xhevahire” të tjera euroskeptike.

Veç kësaj, ky karshillëk absurd injoroi veprimtarinë e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) CEFTA-s, etj; më e keqja, u injorua veprimtaria e Procesit të Berlinit. Fillimisht me justifikimin se “Ballkanin e Hapur” ishte pjesë, instrument dhe njësi e Berlinit; ndërsa më vonë u tha aq se “Ballkani i Hapur” kompensonte dhe zëvendësonte, sipas tyre, Procesin e dështuar të Berlinit dhe Tregun e Përbashkët Rajonal!. Pa mohuar disa mangësi, dhe ato kryesisht për faj të aktorëve/faktorëve rajonalë, kjo nuk qëndron, ndaj dhe është refuzuar nga Berlioni, Brukseli, Parisi, Roma dhe sponsorët e tjerë europianë.

Pas kësaj teze pa pikë besueshmërie me të drejtë lind pyetja: nëse dështon Berlioni dhe Brukseli, ku veç 6 vendeve të rajonit janë dhe 10 vende antare të BE-së, si mund të besojmë se do t’ia dalë mbanë tripalëshi Beo-

grad – Shkup – Tiranë? Kësaj i thonë “më i rëndë bishti se sqepari”!

Mesa duket, ky karshillëk i ngutshëm nuk i dha kohën e duhur Vuçiç-it, Ramës dhe Zaev-it që të dilnin me një platformë të qartë, me parime dhe rregulla bazë dhe me një strukturë tip sekretariati, për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e kësaj nisme; për pasojë, “Ballkani i Hapur” lindi “pa kokë dhe pa këmbë”.

Gjithashtu, po për shkak të atij zelli dhe yryshi anti-europian, trinomi i lartpërmendur nuk bëri hapin e parë dhe më elementar diplomatik – konsultimin dhe konsensusin aq të nevojshëm nga partnerët tanë më të mëdhenj, BE-ja dhe SHBA-të. Këtë gjë u kujtuan ta bëjnë “pas pilafit” por pa efekt.

Ashtu, sikurse duhej marrë pëlqimi i Merkel, si ideatore e “Procesit të Berlinit” ku, pavarësisht nga emri, pjesëmarrës janë dhe Italia, Franca, Austria, Polonia etj. Mirëpo, pa pëlqimin e tyre nuk ka se si të mendohet për sukses!

E keqja vazhdoi me faktin se veç Malit të Zi dhe Bosnie – Hercegovinës u la krejt pas dore Kosova, ndonëse me të kemi marrëveshje për mendim dhe veprim të përbashkët diplomatik. E “lamë në baltë” Prishtinën për hir të Beogradit, duke e ndihmuar këtë të fundit në demarshet e panumurta për defaktorizimin e Kosovës dhe imazhit të saj ndërkombëtar. Injorua ndjeshmëritë, dyshimet dhe rezervat e saj madhore, duke i dhënë përparësi Beogradit. Aventurë e pajustificueshme për politikën dhe diplomacinë tonë,

e cila duhet ta ketë Kosovën përparësi absolute kudo, me çdo kusht dhe në çdo rrethanë në gjithë veprimtarinë diplomatike.

Ky amatorizëm duket dhe në faktin që Rama nuk ka dashur të dëgjojë dhe kuptojë “JO”-në diplomatike nga partnerët gjermanë dhe europianë, të shprehur në plot raste në Tiranë, Berlin, Bruksel dhe gjatë. As mbështetjen e kufizuar dhe të kushtëzuar amerikane. Para disa kohësh ai sfidoi dhe vetë Escobarin në Beo-

**Amatorizmi dhe aventurizmi ynë diplomatik u shfaq sidomos pas agresionit rus ndaj Ukrainës dhe “gurit të provës” dmth qëndrimit të vendeve antare/kandidate ndaj Ruisë. Ishte rasti më i mirë që dhe ne të kërkonim nga Beogradi një qëndrim të qartë ndaj Kosovës, si kusht i domosdoshëm për vazhdimin e mëtejshëm të “Ballkan i Hapur”. Mirëpo Rama vazhdoi të bënte të kundërtën, duke mirëkuptuar, mbrojtur dhe promovuar me zell qëndrimet refraktare serbe, si avokat i saj në të gjitha forumet Euro – Atlantike dhe kur denoncoi me të drejtë Raportin e Dick Martyt në Strasburg!**

grad, kur e tha troç se “Ballkani i Hapur është shumë më tepër se ekonomi dhe tregti, është shumë më tepër dhe se politikë, është projekt i madh paqeje”! Ndonëse dhe “bufi e di”se në rajon paqen dhe sigurinë e ka kërcënuar dhe po e kërcënon Serbia me mbështetjen ruse dhe askush tjetër!

Amatorizmi politik u shfaq dhe në injorimin e faktit se BE-ja ka akorduar 29 miliard Euro deri në vitin 2027 për zbatimin e Tregut të Përbashkët Rajonal. Në këto kushte, BE-ja, Brukseli dhe Berlioni nuk ka si “të zgjidhë qesen” për “Ballkan i Hapur”! Se kësaj i thonë “dhentë dhe dhitë e Zeres dhe nami i Hasan Qerres”!!

Amatorizmi dhe aventurizmi ynë diplomatik u shfaq sidomos pas agresionit rus ndaj Ukrainës dhe “gurit të provës” dmth qëndrimit të vendeve antare/kandidate ndaj Ruisë. Ishte rasti më i mirë që dhe ne të kërkonim nga Beogradi një qëndrim të qartë ndaj Kosovës, si kusht i domosdoshëm për vazhdimin e mëtejshëm të “Ballkan i Hapur”. Mirëpo Rama vazhdoi të bënte të kundërtën, duke mirëkuptuar, mbrojtur dhe promovuar me zell qëndrimet refraktare serbe, si avokat i saj në të gjitha forumet Euro – Atlantike dhe kur denoncoi me të drejtë Raportin e Dick Martyt në Strasburg! Edhe kur Lavrov shprehu hapur mbështetjen për “Ballkan i Hapur” kjo u konsiderua satirë politike! Kësaj i thonë “I zoti e shet, tellalli se jep!”

Ka ardhur koha që gjithkush, e sidomos lidershipi ynë politik ta kuptojë se sot, përpara verës, konjakut, shalqinit, pra bash-

këpunimit ekonomik dhe tregtar, prej të gjithëve, por sidomos prej Serbisë problematike kërkohet qartësimi i pozicionit të saj gjeopolitik, besueshmëria dhe garancitë politike, sidomos në qëndrimet ndaj Rusisë dhe shenja afrimi, zbutjeje dhe jo largimi dhe acarimi me Prishtinën. Nëse “Ballkani i Hapur” është projekt paqeje, atëherë, Serbia përpara se ta ftojë Kosovën në atë nismë, le të njohë krimet dhe genocidin ndaj Kosovës, të kërkojë ndjesë publike dhe të shpallë njohjen e saj, qoftë dhe shkallë shkallë; por jo të shpallë mobilizim ushtarak emergjent, siç po bën tani për targat e kahershme!

Amatorizmi dhe karshillëku ynë diplomatik është shfaqur dhe kur lobonim zgjerimin e “Ballkanit i Hapur” me vende të tjera, antare dhe kandidate të BE-së, duke abuzuar me kortezinë e tyre të njohur diplomatike. Çfarë ironie me to kur ty nuk të bashkohen tri vendet e Ballkanit Perëndimor dhe pjesa më e madhe e publikut, ekspertëve dhe medias as në Tiranë, Shkup dhe Beograd!

Po kështu, në mënyrë absurde, Rama e “ngriti shumë pjacën” kur njoftoi nga tribuna e lartë e OKB-së se Turqia dhe Greqia mund të bëhen pjesë e “Ballkanit i Hapur”! Imagjinoni tani një “picirruk” gjeopolitik dhe diplomatik që kërkon të bashkojë në hyqmin e vet “pesha të rënda gjeopolitike” si Turqia; ca më tepër kur kjo e fundit kryeson “Detin e Zi”! Në një kohë kur “Ballkanit të Hapur” nuk denjojnë me të drejtë t’i bashkohen Slovenia, Kroacia apo dhe Bullgaria!

Tani, të ftosh shtetet e lartpër-



*Po kështu, në mënyrë absurde, Rama e “ngriti shumë pjacën” kur njoftoi nga tribuna e lartë e OKB-së se Turqia dhe Greqia mund të bëhen pjesë e “Ballkanit i Hapur”! Imagjinoni tani një “picirruk” gjeopolitik dhe diplomatik që kërkon të bashkojë në hyqmin e vet “pesha të rënda gjeopolitike” si Turqia; ca më tepër kur kjo e fundit kryeson “Detin e Zi”! Në një kohë kur “Ballkanit të Hapur” nuk denjojnë me të drejtë t’i bashkohen Slovenia, Kroacia apo dhe Bullgaria!*

mendur në “Ballkanit i Hapur” është njësoj sikur “Benelux” të ftonte Parisin, Berlinin dhe Romën të bëheshin pjesë e tij pas vitit 1945! Nuk kishte asgjë të keqe, por në diplomaci nuk ndodh kurrë kështu! Përkundrazi, ndonëse Benelux u krijua i pari, ishin Franca, Gjermania dhe Italia që ftuan Belgjikën, Holandën dhe Luksemburgun për të krijuar BE-në më 1957!

Për të gjitha sa thamë më lart, 3 Nëntori berlinez është mundësia më e mirë dhe koha e duhur për t’i dhënë fund një herë e mirë amatorizmit dhe aventurizmit diplomatik me “Ballkanin e Hapur”. Boll më!

Natyrisht është në të drejtën e tyre që Beogradi, Tirana dhe Shkupi të vazhdojnë “avazin e

Mukes” me “Ballkanin e Hapur”; por ky paralelizëm dhe karshillëk i panevojshëm dhe i dëmshëm politik dhe diplomatik është pa kuptim, pa perspektivë dhe absurditet. Ja pse, qoftë dhe për t’i shpëtuar “nderin,” ishte e udhës që në prag të Samitit në Berlin, liderët e tij të kishin hequr dorë “me lezet” dhe me nga një fjalë të mirë nga “Ballkanit i Hapur”; fare thjesht, duke shpallur shkrirjen e tij të natyrshme të “Procesi i Berlinit dhe Tregu i Përbashkët Rajonal”. Por këtë mund ta bëjnë dhe tani, se nuk është vonë për gjëra të mira. Ca më tepër se Samiti i ardhshëm i Procesit të Berlinit do të zhvillohet në Tiranë, në Mars 2023. Sepse, le ta përsërisim për ata që duan të dëgjojnë: Procesi i Berlinit “na del dhe na tëpëron”!



